

2.08.2024

Ora, 20:17

RENDI I DITËS

“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 8, datë 02.08.2024 të depozituar nga Arqilea Bollano, kryetar i komanduar, Bashkia Himarë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako (online), z. Elvis Çefa,
z. I. Rusmali, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** BF (z. I. Kaso)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. E. Çefa: Mirëdita të gjithëve! Deklarojmë të çelur seancën për shqyrtimin paraprak të kërkesës ankimore me nr. 8 të paraqitur në KQZ nga subjekti ankimues kryetari i komanduar i Bashkisë Himarë, zoti Arqilea Bollano, me objekt: shfuqizimin e projektvendimit nr. 159, dt. 1.08.2024 “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si një vendim i marrë në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Kërkesa ankimore është paraqitur dhe protokolluar në KQZ, sot. Pas shortit të hedhur, relator i kësaj çështje jam unë, anëtari i KAS-it, Elvis Çefa. Në këtë seancë paraprake, verifikojmë pjesëmarrjen! Është prezent trupa e KAS, në përbërje të tij në sallë, janë tre anëtarë. Ndërkohë që për arsye objektive, anëtari Bele, e ka të pamundur të jetë prezent. Kjo nuk e pengon KAS-in të vijojë procedimin. Ndërkohë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 2.08.2024*

kemi dhe anëtarin tjetër zotin Lako, i cili është i lidhur online me këtë sallë dhe po na ndjek duke pasur mundësi të komunikojë me ne. Zoti Lako, më dëgjoni?

Z. E. Lako: Po zoti Çefa, ju dëgjoj!

Z. E. Çefa: Jemi të lidhur atëherë, jemi në seancë! Nuk është prezent ankimuesi. Më rezulton nga administrata, që është prezent drejtoresha juridike e cila përfaqëson Komisionerin në këtë procedim. Më është komunikuar gjithashtu nga administrata që kemi një kërkesë paraprake nga përfaqësuesi i subjektit “Bashkë Fitojmë”, për të qenë i pranishëm në këtë seancë. Pra, palë pjesëmarrëse, për shkak se pretendohet se ka një interes të ligjshë. Zoti Kaso!

Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”: Po i nderuar! Përfaqësues i subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, Ivi Kaso, sipas aktit të regjistrimit të koalicionit dhe marrëveshjes së koalicionit që është depozituar, si një nga përfaqësuesit ligjorë të koalicionit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kërkoj të bëhem pjesë e këtij shqyrtimi administrativ në kushtet kur ne si koalicion, kemi propozuar kandidatin dhe një nga kandidatët garues që tërheq interesa të ligjshme dhe ka interes të drejtë për drejtë në këtë çështje, është kandidati i propozuar nga ana jonë. Faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! KAS i konsultuar në vend, vendosi të pranojë kërkesën për marrjen pjesë në cilësinë e palës së interesuar, të përfaqësuesit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Ndërkohë administrata më konfirmon nëse, ankimuesi ka dijeni mbi zhvillimin e kësaj seance?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 2.08.2024*

Znj. M. Koja: Po! Ankimuesi është njoftuar me email për zhvillimin e seancës.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Atëherë, meqenëse procedurat paraprahe u përfunduan, po ju jap fjalën zonja Koja, për të na relatuar shkurtimisht kërkesën e ankimuesit dhe për të dhënë mendimin tuaj nëse duhet të kalohet për shqyrtim kjo kërkesë ankimore, apo jo nga KAS!

Znj. M. Koja: Faleminderit zoti Çefa! Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është depozituar një kërkesë ankimore me nr. 8, dt.2.08.2024, me kërkues zotin Arqilea Bollano, kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë. Nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkohet “Kundërshtimi i vendimit nr. 159, dt. 08.2024, i Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për dhënien e autorizimit për ndërrimin e vendndodhjes së qendrës së votimit nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Nga verifikimi paraparak, konstatohet se kërkesa ankimore është brenda afatit ligjor, si dhe i plotëson elementët formalë të parashikuara në nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Për këto arsye, i kërkojmë KAS-it, kalimin e kërkesës për shqyrtim.

Z. E. Çefa: Ju faleminderit! Përfaqësuesi i palës së interesuar!

Z. I. Kaso, përfaqësues i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”: Po, i nderuar! Dy fjalë shkurt lidhur me çështjen e legjitimitetit dhe kompetencës për shqyrtimin e kësaj çështje. Ne vlerësojmë se çështja nuk duhet të kalojë për shqyrtim, për shkak se ankuesi në cilësinë e kryetarit të bashkisë nuk është një nga subjektet e parashikuara shprehimisht që gëzon të drejtën e ankimit përpara KAS-it, ndaj vendimeve të Komisionierit. Në bazë të nenit 124 dhe 124/1 është për të diskutuar çështja e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 2.08.2024*

mbartjes së tij si subjekt i tretë në një interes të ligjshëm në shqyrtimin e kësaj çështje. Po besoj se këtu, kryetari në detyrë, se i tillë është, besoj se dhe kjo është e debatueshme është, i Bashkisë Himarë. Është nënkryetar i caktuar nga një nënkryetar tjetër, një tipologji krejt jashtë kornizave ligjor, por jashtë kësaj... Ngatërron kompetencat e tij në përgatitjen dhe menaxhimin e procesit zgjedhor me kompetencat e KZAZ-së. Në bazë të nenit 33 të Kodit Zgjedhor është KZAZ-ja që mbikqyr dhe ka përgjegjësinë e zhvillimit të procesit zgjedhor. Kryetari i bashkisë ka një kompetencë të vetme, kompetencë të cilën e ka ushtruar. Në momentin që e ka ushtruar kompetencën e tij, e ka ezauruar detyrimin e tij ligjor dhe privilegjin që të ankohet në KAS, ose kudo tjetër, në rast se ushtrimi i kësaj kompetence do t'i mohohet. Nuk rezulton t'i jetë mohuar ushtrimi i ndonjë kompetence. Se çfarë ndodh më pas në aspektet e tjera të menaxhimit të procesit zgjedhor, nuk është fare tagri i tij. Kodi Zgjedhor e parashikon qartë në nenin 33, ku lë KZAZ-në dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve më pas, përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aspekteve të tjera të menaxhimit të procesit zgjedhor. Pika e tretë, përse nuk duhet të legjitimohet, të shqyrtohet kjo ankesë? Objekti i kësaj ankesë është kundërshtimi i një projektvendimi, pavarësisht i cili kundërshtohet formalisht. Mundet të jetë konkretizohet më pas në një vendim, në mungesë të një korigjimi të shprehur me vullnetin e palës, e cila ka vënë në lëvizje KAS-in dhe në kushtet ku kjo palë që ka vënë në lëvizje KAS-in në një kohë kaq të ngushtë nga procesi zgjedhor, shpreh mospërfillje të plotë të interesit për të paraqitur qëndrimet dhe pretendimet e veta, qoftë dhe për të korigjuar këtë aspekt përpara KAS-it. Vlerësoj se jemi përpara kushteve, ku për të treja këto arsye, veç e veç, por aq më tepër në mënyrë kumulative, kjo çështje nuk duhet të kalojë për shqyrtim të mëtejshëm, faleminderit!

Z. E. Çefa: Ju faleminderit zoti Kaso! Nga kolegët pyetje?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 2.08.2024*

Z. I. Rusmali: Pyetjet janë lidhur me përmbajtjen.

Z. E. Çefa: Po sigurisht. Unë do të desha një sqarim të shkurtër nga administrata më shumë për efekt të procesverbalit. Për pretendimin që u ngrit, që në fakt është dhe në ankim. Ankimuesi referohet se ankimon një projektvendim dhe jo vendim. Ndërkohë na është vënë në dispozicion nga administrata vendimi që ka të njejtat ekstremite. Ka të njejtin numër, datë dhe orë.

Znj. M. Koja: Vendimi që ju kemi vendosur përpara është printuar nga faqja zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund të jemi para një lapsusi, po...

Z. E. Çefa: Qartë! Dakord! Ne do të na duhen 10 minuta kohë sa të diskutojmë çështjen dhe do t'ju komunikojmë dhe vendimin për këtë fazë të shqyrtimit. Faleminderit!

Rifillon seanca

Ora 20:45

Z. E. Çefa: Riçelim seancën për shpalljen e vendimit për sa i përket fazës së shqyrtimit paraprak. KAS i konsultuar në vend, vendosi:

- Kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore me nr. 8, dt. 2.08.2024, me subjekt ankimues, kryetarin në detyrë të Bashkisë Himarë.
- Seanca e themelit për shkak të karakterit të ngutshëm të kësaj çështje, merret në konsideratë nga KAS, do të zhvillohet po sot për 30 minuta, në këtë sallë.

Me kaq e deklaroj të mbyllur këtë seancë, faleminderit!

Vendimi nr. 14

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

